



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.5.2023

Nr: 539

Ora: 19:00

VENDIM
PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 4 (katër) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 47, ZAZ nr. 48, ZAZ nr. 49 dhe ZAZ nr. 50.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Elbasan, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Elbasan.

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore,

Data: 20.5.2023 Nr: 539
Ora: 19:00



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 47, KZAZ nr. 48, KZAZ nr. 49 dhe KZAZ nr. 50 kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Elbasan dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Elbasan, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Elbasan, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 47, ZAZ nr. 48, ZAZ nr. 49 dhe ZAZ nr. 50, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të çdo QV-je të zonës zgjedhore, përveç rezultateve të tabelës përmbledhëse për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Këshillit të Bashkisë për KZAZ nr. 47 ku mungon rezultati për QV-të si më poshtë:

- 2481/01; 2432/00; 2483/00; 2473/01 dhe 2470/00.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me urdhrin me nr. 80, datë 19.05.2023, ka urdhëruar KZAZ nr. 47, Bashkia Elbasan, të plotësojë menjëherë tabelat dhe t'i ridërgojnë ato brenda 24 (njëzet e katër) orëve në KQZ.

Pas përfundimit të afatit për plotësimin e tabelave nga KZAZ nr. 47, kjo e fundit nuk ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve. Në këtë rast, veprohet sipas përcaktimeve të nenit 123, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Elbasan dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Elbasan, Qarku Elbasan, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin e Bashkisë Elbasan, të KZAZ nr. 47, Bashkia Elbasan, sipas lidhjes nr 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Elbasan sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: 20.5.2023 Nr: 539
Ora: 19:00



"Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

3. Shpalljen fitues të z. Gledian Llatja si Kryetar i Bashkisë Elbasan, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
4. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Elbasan, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

BASHKIA ELBASAN, QARKU ELBASAN

Lidhja 1



		ZAZ 47	ZAZ 48	ZAZ 49	ZAZ 50	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	63.912	38.644	35.129	33.540	171.225
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	26.515	13.980	12.667	12.450	65.612
3	Vota të pavlefshme	568	411	357	379	1.715
4	Vota të vlefshme	25.947	13.569	12.310	12.071	63.897
1	Gledian Iljaz Llatja	15.372	7.570	6.526	6.517	35.985
2	Luçiano Dhimitër Boçi	10.575	5.999	5.784	5.554	27.912
	Totali i votave të vlefshme	25.947	13.569	12.310	12.071	63.897



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

BASHKIA ELBASAN, QARKU ELBASAN



Lidhja 2

		ZAZ 47	ZAZ 48	ZAZ 49	ZAZ 50	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	63912	38644	35129	33540	171.225
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	26612	13980	12667	12454	65.713
3	Vota të pavlefshme	238	216	179	183	816
4	Vota të vlefshme	26374	13764	12488	12271	64.897
1	Bashkë Fitojmë	4800	3283	3326	3212	14621
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	13708	6704	5908	5935	32255
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	369	180	221	179	949
4	Partia Republikane Shqiptare	405	71	71	69	616
5	Partia Levizja e Legalitetit	344	135	171	150	800
6	Partia Demokracia Sociale	1071	123	128	156	1478
8	Partia Socialdemokrate	825	276	252	212	1565
9	Partia Demokratike	3708	1703	1536	1466	8413
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	247	140	117	210	714
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	287	394	264	265	1210
15	Bindja Demokratike	204	88	97	61	450
18	Partia Balli Kombëtar	65	135	56	102	358
23	Partia e Gjelbër	256	455	298	233	1242
33	Partia Ora e Shqipërisë	85	77	43	21	226
	Totali i votave të vlefshme	26.374	13.764	12.488	12.271	64.897